



**International  
Federation of  
Library  
Associations and Institutions**



# Manifesti i IFLA-UNESCO-s për Bibliotekat Publike 2022<sup>1</sup>

Liria, mirëqenia dhe zhvillimi i shoqërisë dhe individëve janë vlerat themelore njerëzore. Ato mund të arrihen vetëm nëpërmjet aftësive të qytetarëve të mirëinformuar për të ushtruar të drejtat e tyre demokratike dhe të luajnë një rol aktiv në shoqëri. Pjesëmarrja konstruktive në shoqëri dhe zhvillimi i demokracisë varen nga niveli i kënaqshëm i arsimit, si dhe nga qasja e lirë dhe e pakufizuar në dije, mendim, kulturë dhe informacion. Biblioteka publike, porta lokale drejt dijes, siguron kushtet bazë për të mësuarit gjatë gjithë jetës, vendimmarrjen e pavarur dhe zhvillimin kulturor të individit dhe grupeve sociale. Ajo përforcon shoqëritë e shëndetshme të dijes, përmes sigurimit të qasjes dhe mundësimit të krijimit dhe shpërndarjes së dijeve, duke përfshirë njohuritë shkencore dhe vendore pa kufizime tregtare, teknologjike ose ligjore. Në çdo komb, por veçanërisht në vendet në zhvillim, bibliotekat ndihmojnë për të siguruar që të drejtat për arsimim dhe pjesëmarrje në shoqëritë e dijes dhe në jetën kulturore të komunitetit të jenë të qasshme për sa më shumë njerëz që të jetë e mundur.

Ky Manifest deklaron besimin e UNESCO-s tek biblioteka publike si një forcë jetike në arsimim, kulturë, përfshirje dhe informim dhe si një agjent thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm dhe për realizimin individual të paqes dhe mirëqenies shpirtërore në mendjet e gjithë individëve.

Ndaj UNESCO inkurajon qeveritë kombëtare dhe vendore të mbështesin dhe të punojnë në mënyrë aktive në zhvillimin e bibliotekave publike.

## Biblioteka publike

Biblioteka publike është qendra lokale e informacionit, duke bërë të mundur dhe vënë në shërbim të përdoruesve të saj në mënyrë të menjëherëshme, të gjitha llojet e dijeve dhe informacioneve. Ajo është një

---

<sup>1</sup> Manifesti i IFLA-UNESCO-s për bibliotekat publike i vitit 2022 paraqet një përditësim të këtij mjeti të rëndësishëm për përkrahjen e bibliotekave. Përditësuar për herë të fundit në vitin 1994, botimi i ri merr në konsideratë ndryshimet në teknologji dhe shoqëri, në mënyrë që të sigurojë që manifesti vijon të pasqyrojë realitetet dhe misionin e bibliotekave publike sot.

Përkthimi në gjuhën shqipe është realizuar nga Elisabeta Koka, rishikuar dhe redaktuar nën kujdesin e Ederina Demo, Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë. Ky manifest është publikuar online edhe në faqen zyrtare të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, i qasshëm përmes URL [\[https://bksh.al/uploads/\\_originals/7db07593-3604-46bf-a461-0a4063ebb5bd.pdf\]](https://bksh.al/uploads/_originals/7db07593-3604-46bf-a461-0a4063ebb5bd.pdf)

komponent thelbësor i shoqërive të dijes, duke u përshtatur vazhdimisht me mediat e reja të komunikimit për të përmbushur detyrën e ofrimit të qasjes universale në informacion dhe për të mundësuar që ai të përdoret me kuptim për të gjithë njerëzit. Ajo siguron hapësirë publike të qasshme për prodhimin e dijes, shpërndarjen dhe shkëmbimin e informacionit dhe kulturës, si dhe përkrahjen e përfshirjes qytetare.

Bibliotekat janë krijuese të komunitetit, duke arritur në mënyrë proaktive audiencë të reja dhe duke përdorur dëgjimin efektiv për të mbështetur hartimin e shërbimeve që plotësojnë nevojat lokale dhe kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës. Publiku i beson bibliotekës së tij dhe në këmbim, biblioteka publike synon të mbajë komunitetin e saj të informuar dhe të vetëdijshëm në mënyrë dinamike.

Shërbimet e bibliotekës publike ofrohen në bazë të mundësive të barabarta të qasjes për të gjithë, pavarësisht nga mosha, etnia, gjinia, feja, kombësia, gjuha, statusi shoqëror dhe çdo karakteristikë tjetër. Sigurohen shërbime dhe materiale të veçanta për ata përdorues që nuk mundën, për çfarëdo arsye, të përdorin shërbimet dhe materialet e zakonshme, për shembull pakicat gjuhësore, personat me aftësi të kufizuara, me aftësi të dobëta digjitale ose kompjuterike, me nivel të pamjaftueshëm në të shkruar dhe të lexuar ose njerëzit në spitale apo burgje.

Të gjitha grupmoshat, duhet të gjejnë materiale në përshtatje me nevojat e tyre. Koleksionet dhe shërbimet duhet të përfshijnë të gjitha llojet e mediave të duhura dhe teknologjitë moderne, si edhe materialet tradicionale. Themelore janë cilësia e lartë, përshtatshmëria me nevojat dhe kushtet lokale dhe reagimi ndaj larmisë gjuhësore dhe kulturore të komunitetit. Materialet bibliotekare duhet të pasqyrojnë prirjet aktuale dhe zhvillimin e shoqërisë, si dhe kujtesën e përpjekjeve dhe imagjinatës njerëzore.

Koleksionet dhe shërbimet bibliotekare nuk duhet të jenë subjekt i asnjë forme censurimi ideologjik, politik ose fetar, as i presioneve tregtare.

## Misionet e bibliotekës publike

Misionet kryesore të mëposhtme, të cilat kanë të bëjnë me informacionin, shkrimin dhe leximin, edukimin, përfshirjen, pjesëmarrjen qytetare dhe kulturën duhet të jenë në qendër të shërbimeve të bibliotekave publike. Nëpërmjet këtyre misioneve kryesore, bibliotekat publike kontribuojnë në objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe në ndërtimin e shoqërive më të drejta, më njerëzore dhe më të qëndrueshme.

- Sigurimi i qasjes në një gamë të gjerë informacioni dhe idesh pa censurë, duke mbështetur arsimin zyrtar dhe jozyrtar në të gjitha nivelet, si dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës duke mundësuar kërkimin e vazhdueshëm, vullnetar dhe të vetëdrejtuar të dijeve për njerëzit në të gjitha fazat e jetës;
- ofrimi i mundësive për zhvillimin krijues personal dhe nxitja e imagjinatës, kreativitetit, kuriozitetit dhe ndjeshmërisë;
- krijimi dhe forcimi i shprehive të leximit tek fëmijët që nga lindja deri në moshën madhore;
- ndërmarrja e nismave, mbështetja dhe pjesëmarrja në aktivitetet dhe programet e shkrimit dhe leximit për të zhvilluar këto aftësi, duke ndihmuar në zhvillimin e aftësisë në media dhe informacion dhe aftësive digjitale për të gjithë njerëzit e të gjitha moshave, në frymën e përgatitjes së një shoqërie të informuar dhe demokratike;
- ofrimi i shërbimeve për komunitetet e tyre si fizikisht, ashtu edhe në distancë nëpërmjet teknologjive digjitale duke lejuar qasje në informacion, koleksione dhe programe kurdoherë që është e mundur;

- sigurimi i qasjes për të gjithë njerëzit në çdo lloj informacioni për komunitetin dhe mundësive për organizimin e komunitetit, në njohjen e rolit të bibliotekës në thelb të strukturës shoqërore;
- ofrimi i qasjes në dijet shkencore, të tilla si rezultatet e kërkimit dhe informacion shëndetësor që mund të ndikojnë në jetën e përdoruesve, në të njëjtën kohë duke mundësuar pjesëmarrjen në përparimin shkencor;
- ofrimi i shërbimeve të duhura të informacionit për ndërmarrjet, shoqatat dhe grupet e interesit lokal;
- ruajtja dhe bërja e qasshme e të dhënave, dijeve dhe trashëgimisë lokale dhe vendase (përfshirë traditën gojore), duke siguruar një mjedis në të cilin komuniteti lokal mund të marrë një rol aktiv në identifikimin e materialeve që duhen mbajtur, ruajtur dhe shpërndarë, në përputhje me dëshirat e vetë komunitetit;
- nxitja e dialogut ndërkulturor dhe përkrahja e larmisë kulturore;
- promovimi i ruajtjes/konservimit dhe qasja kuptimplotë ndaj shprehjeve dhe trashëgimisë kulturore, vlerësimi i artit, qasja e hapur ndaj dijeve shkencore, kërkimit dhe risive, të shprehura si përmes mediave tradicionale, ashtu edhe përmes materialeve të lindura digjitale apo të digjitalizuara.

## Fondet buxhetore, legjislacioni dhe rrjetet

Qasja si në ndërtesë edhe në shërbimet e bibliotekës publike në parim është pa pagesë. Biblioteka publike është në përgjegjësi të autoriteteve lokale dhe kombëtare. Ajo duhet të mbështetet në një legjislacion të veçantë dhe të përditësuar në përputhje me traktatet dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Ajo duhet të financohet nga qeveritë kombëtare dhe vendore. Duhet të jetë një komponent thelbësor i çdo strategjie afatgjatë për kulturën, sigurimin e informacionit, aftësimin për të shkruar dhe lexuar dhe arsimin.

Në erën digjitale, legjislacioni për të drejtën e autorit dhe pronësinë intelektuale duhet t'u sigurojë bibliotekave publike të njëjtën mundësi për të siguruar dhe ofruar qasje përmbajtjeve digjitale me kushte të arsyeshme, siç veprohet me burimet fizike.

Për të siguruar koordinimin dhe bashkëpunimin mbarëkombëtar të bibliotekave, legjislacioni dhe planet strategjike duhet, gjithashtu, të përcaktojnë dhe promovojnë një rrjet kombëtar bibliotekar bazuar në standarde të miratuara shërbimi.

Rrjeti i bibliotekave publike duhet të planifikohet në lidhje me bibliotekat kombëtare, rajonale, kërkimore dhe të veçanta, si dhe me bibliotekat shkollore, të kolegjeve dhe universiteteve.

## Funksionimi dhe menaxhimi

Duhet të hartohet një politikë e qartë, ku të përcaktohen objektivat, përparësitë dhe shërbimet në lidhje me nevojat e komunitetit vendas. Rëndësia e njohurive vendase dhe pjesëmarrja e komunitetit është me shumë vlerë për një proces të tillë dhe komunitetet vendase duhet të përfshihen në vendimmarrje.

Biblioteka publike duhet të organizohet në mënyrë efektive dhe duhet të ruhen standardet profesionale të funksionimit.

Shërbimet duhet të jenë të qasshme si fizikisht, ashtu edhe në formë digjitale për të gjithë anëtarët e

komunitetit. Kjo kërkon që ndërtesat e bibliotekave të jenë të pozicionuara në vende të përshtatshme dhe të pajisura mirë, të kenë mjete të mira leximi dhe studimi, si dhe teknologji të përshtatshme e të përditësuara dhe orare të mjaftueshme shfrytëzimi të përshtatshme për përdoruesit. Në të njëjtën mënyrë duhet të përfshihen edhe shërbimet në terren për ata që janë të pamundur për të vizituar bibliotekën.

Shërbimet e bibliotekës duhet t'u përshtaten nevojave të ndryshme të komuniteteve në zonat rurale dhe urbane, si dhe nevojave të grupeve të marginalizuara, përdoruesve me nevoja të veçanta, përdoruesve që flasin dhe përdorin shumë gjuhë dhe popullsisë vendase (indigjene) brenda komunitetit.

Bibliotekari është një ndërmjetës aktiv midis përdoruesve dhe burimeve si digjitale, ashtu edhe tradicionale. Për të garantuar shërbime adekuat janë domosdoshmëri burimet e mjaftueshme njerëzore dhe materiale, si dhe edukimi profesional dhe i vazhdueshëm i bibliotekarit, për të përballuar sfidat në të tashmen dhe në të ardhmen. Drejtuesit e bibliotekave duhet të këshillohen me bibliotekarë profesionistë në lidhje me përcaktimin sasior dhe cilësor të burimeve të mjaftueshme.

Duhet të ofrohen programe të ndërgjegjësimit dhe edukimit të përdoruesve për t'i ndihmuar ata të përfitojnë nga të gjitha burimet.

Hulumtimi i vazhdueshëm duhet të përqendrohet në vlerësimin e ndikimit të bibliotekës dhe mbledhjen e të dhënave, në mënyrë, që t'u tregojë politikbërësve dobinë e bibliotekave për shoqërinë. Të dhënat statistikore duhet të mblidhen në mënyrë afatgjatë, pasi përfitimet që sjellin bibliotekat në shoqëri shihen shpesh në brezat e ardhshëm.

## Partneritetet

Ndërtimi i partneriteteve është thelbësor për të mundësuar që bibliotekat të arrijnë një publik më të gjerë dhe më të larmishëm. Duhet të sigurohet bashkëpunimi me partnerët përkatës - për shembull, grupet e përdoruesve, shkollat, organizatat joqeveritare, shoqatat e bibliotekave, bizneset dhe profesionistët e tjerë në nivel lokal, rajonal, kombëtar si dhe ndërkombëtar.

## Zbatimi i Manifestit

Vendimmarrësit në nivele kombëtare dhe vendore dhe komuniteti bibliotekar në përgjithësi, në mbarë botën, nxiten të zbatojnë parimet e shprehura në këtë Manifest.

*18 korrik 2022*